



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 113, datë 30.09.2021

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS, QË I PËRKET SHKOLLËS SË MESME “OLSI LASKU”, QË MBAN NR. 159, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET E TË NDËRTOHET NGA E PARA, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR E HARTUAR NGA STUDIO SHOQËRIA “ARKONSTUDIO” SHPK DHE OPONENCËS TEKNIKE TË KRYER NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE TË PRONËS ME EMËRTIMIN SHKOLLA E MESME “OLSI LASKU”, QË MBAN NR.159 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019, “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr. 661/38 prot., datë 22.09.2021, ardhur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike (Sektori i Projekteve Publike), me lëndë: “Përcjellje të ekspertizave të thelluara dhe të oponencës teknike të objekteve arsimore”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit

publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Arsim-Kulturës, Rinisë, Sport, Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket Shkollës së Mesme “Olsi Lasku”, me vendodhje Rruga “Bajram Tusha”, që mban nr. 159 të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe është rekomanduar të priset e të ndërtohet nga e para, kjo sipas aktekspertizës së thelluar e hartuar nga studio Shoqëria “Arkonstudio” shpk dhe oponentës teknike, e kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista përfundimtare të pronës me emërtimin Shkolla e Mesme “Olsi Lasku”, që mban nr. 159 të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës.
3. Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me emërtimin Shkolla e Mesme “Olsi Lasku”, që mban nr. 159 të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës.
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shëmbjen e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohen nga Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Bashkia Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, që bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese, që administrojnë fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e objektit me emërtimin Shkolla e Mesme “Olsi Lasku”, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të rindërtimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Arsim-Kulturës, Rinisë, Sport, Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.10.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 754/prot.

Durrës, më 07.10.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.113 datë 30.09.2021 “Mbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket shkollës së mesme “Olsi Lasku”, që mban nr. 159, të listës së transferimit, që me VKM Nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe është rekomanduar të priset e të ndërtohet nga e para, kjo sipas aktekspertizës së thelluar e hartuar nga studio shoqëria “Arkonstudio” shpk dhe oponencës teknike të kryer nga Instituti i Ndërtimit dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin shkolla e mesme “Olsi Lasku”, që mban nr.159 të listës së transferimit, që me VKM Nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

